V E N D I M
Nr. 119, datë 16.2.1998

PËR KALIMIN KAPITAL PA PAGESË TË NDËRTESËS 4-KATËSHE NË RRUGËN E ELBASANIT DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndërtesa 4-katëshe në rrugën e Elbasanit, në Tiranë (e emërtuar "Triko me porosi"), deri tani në pronësi të Bankës Tregtare Agrare, i bëhet kalim kapital pa pagesë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

2. Për zbatim të këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Banka Tregtare Agrare.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 601, datë 31.12.1997 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano